



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 966/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shpend Venhari nga Prishtina, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të emrit të personit në listat e votuesve, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e pa lejuar ankesa e Shpend Venhari nga Prishtina.

Arsyetim

Me datën 01.12.2013, Shpend Venhari, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, në listën përfundimtare të votuesve gjendet emri i nënës së tij Bahrije Venhari e cila ka ndërruar jetë në vitin 2006.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pa lejuar

PZAP-i, vendos ndaj vendimeve të KQZ-së sipas nenit 122 të LZP-së, prandaj edhe konstatoi se ankesa është e palejuar sepse nuk është në juridiksionin e PZAP-it, që të ndërmerr masa përmirësuese ndaj listës së votuesve në rastet kur gjendet një emër i ndonjë personi i cili ka ndërruar jetë, ngase një çështje e tillë nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 966/2013 më datën 02.12.2013.



Këshillë Juridike:

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*